

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Departamenti I
 Pergjithshem – Divizioni Civil, Gjyqtari Skender Shala, ne qeshtjen juridike te
 paditesit nga Fsh. , Komuna e te cilin sipas
 autorizimit me shkrim e perfaqson Av. nga , kunder te paditurit
 nga Fsh. Komuna e tani me vendbanim te panjohur,
 te cilen e perfaqeson perfaqesuesi i perkohshem avokati nga
 sipas aktvendimit te kesaj gjykate, per vertetim pronsie, vlera e kontestit
 2.300 Euro, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor dhe publik, te dt. 04.01.2017, me dt.
 19.01.2017, bie kete:

AKT GJYKIM

I – VERTETOHET se paditesi nga Fsh. , Komuna e
 eshte pronar i paluejtshmerise – pjeses se ngastres katastrale nr. , ne
 siperfaqe prej **S=1668 m2**, me kulture are e klases se pese, ne vendin e quajtur
 “ ” me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes dhe i
 paluejtshmerise – pjeses se ngastres katastrale nr. ne siperfaqe prej **S=2045**
m2, me kulture are e klases se pese, ne vendin e quajtur “ ’ me masat dhe kufijte
 qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes , e tera kjo evidentohet ne emer te te
 paditurit () 1/1, ZK

II – OBLIGOHET i padituri qe t’ia njohe kete te drejte paditesit dhe t’i
 lejoje qe paditesi kete paluajtshmeri ta regjistroj ne emer te tij, ne librat e tokes te
 Zyra Kadastrale Komunale ne ne afatin prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga
 dita e pranimit te ketij aktgjykimi, nen kercenim te permbarimit.

Secila pale i barte shpenzimet e tjera te procedures kontestimore.

Arsyetim

Paditesi ne padin e tij te parashtruar dhe permes te autorizuarit te tij ne
 seancat e mbajtura ka theksuar se babai I tani paditesit ne vitin 1966 ne baze te
 kontrates gopjore, e ka blere nga i padituri paluejtshmerine me çmim prej
 100.000,00 dinare te atehershem , te cilin çmim ia ka paguar ne teresi shitesit dhe se
 prej atij momenti ka hyre ne shfrytezim dhe posedim te papenguar dhe te panderprer e
 gjer me tani, andaj ka interes juridik qe te vertetohet se ai eshte pronar i pjeses te
 kesaj paluejtshmerie. Pas vdekjes se te atit te paditesit dhe ndarjen fizike te bashkesise
 familjare, paditesi I ka takuar diku afer 36 ari.

Pasi qe e paditura eshte ne adrese te panjohur i propozoje gjykates qe te ia caktoi perfaqesuesin e perkohshem.

I autorizuar i paditesit ne seancen e shqyrtimit kryesor deklaroi se mbetem ne teresi prane padise dhe kerkespadise se parashtuar me propozim qe duke bere precizimin e kerkespadise sa I perket siperfaqes, shtrirjes dhe perkufizimit te paluajtshmerise dhe ate sipas konstatimit dhe mendimit te ekspertit gjeodet te cekur si ne ekspertizen e dt. 30.11.2016. Njeherit propozoj qe lidhur me rrethanat nga padija te degjohen ne cilesi te deshmitareve: nga fsh., Komuna e dhe nga fsh. Komuna e. Ne fjalen perfundimtare theksoi se pas mbajtjes se seancevegjyqsore dhe adminstrimit te provave ne kete ceshtje pronesore-juridike tani lendore vertetohet vakti se paditesi me ane te mbajtjes me mirebesim I pasurise se paluajtshme qe nga viti 1966, dhe conform dispozites 28 te LTHMPJ-se nga te lartecekura e propozpj gjykates qe te apvoroj padine dhe kerkespadine si ne precizim te saj te bazuar.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Ne baze te propozimit te autorizuarit te paditesit e conform nenit 79.1.3/a dhe 81.1 te LPK-es, gjykata me aktvendimin C.nr.531/2015 te dt.05.10.2016, te paditurit ia caktoi Perfaqesuesin e perkohshem, zv. , i cili ne baze te ketij aktvendimi do t'i ushtron te drejtat dhe detyrimet, conform nenit 82.1.2 te LPK-es.

Perfaqesuesi i perkoheshem i te paditurit ne pergjigje te padise dhe kerkespadise dhe seancen e shqyrtimit kryesor theksoi se fillimisht e kundershtoj padin dhe kerkespadin e paditesit, nuk e kundershtoj nxerjen e provave, kurse ne fjalen e tij perfundimtare deklaroi se Gjykates I propozoj qe conform rrezultatit te provave ne proceduren provuese te bie vendim meritor lidhur me kete ceshtje juridike-civile

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Gjykata me qellim te vertetimit te drejte dhe te plote te gjendjes se fakteve per aq sa palet ndergjygjese i parashtuan ato dhe propozuan prova per provimin e tyre, ne kuptim te nenit 7 te LPK-se, ne proceduren e provave ne shqyrtimin kryesor te mbajtur me dt. 04.02.2014, beri administrimin e provave me leximin e: certifikata e pronesise me numer te lendes ZK ne emer te te paditurit, procesverbalit mbi vendeshiqimin te kesaj gjykate C.nr.511/2015 I dt. 04.11.2016, beri veshtrim ne skicen e terenit dhe kopien e planit nga I njejti eksperti gjeodet, degjoi deshmitarit dhe dhe konstatoi kete gjendje faktike:

Gjykata pasi qe beri analizimin dhe vleresimin e seciles prove veq e veq e ne lidheshmeri njera me tjetren, qmuarjes me kujdes dhe ndergjegjje, e duke u mbeshtetur me dispoziten e nenit 8 te LPK-se, arriti ne perfundim se ne rastin konkret duhet vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi nga arsyet si ne vijim:

Nga Certifikata mbi te drejtat e pronës se paluajtshme të cekur me lart, konstatohet se pjesët e parcelave katastrale nr _____ dhe _____, evidentohet në emer të te paditurit.

Nga procesverbali mbi vendeshiqimin të kësaj gjykate të cekur me lart, konstatohet se gjyqtari me vrotim të drejtperdrejt në vende dhe sipas deklaratës së ekspertit konstatoi se paluajtshmerija është e kufizuar në anën veriore me rrugën regjionale _____, në anën lindore, perendimore dhe jugore kufizohet me pronë private. Pjesa dermuese e paluajtshmerisë është e rrethuar dhe e ndame me rrethoj prej teli. Në këtë paluajtshmeri janë të ndertuara katër objekte banesore ndërsa pjesa tjetër është e mbjellur me barë dhe në të shfrytëzohet për kopsht, pemë të mbjellura dhe kullorë-livadh.

Nga konstatimi dhe mendimi i ekspertit gjeodet të cekur me lart, konstatohet se pas matjeve të kryera në pjesët e parcelave kontestuese nga ana e ekspertit gjeodet dhe në baze të dokumentacionit, me të cilin posedon për momentin Drejtoria e Gjeodezisë dhe Katastrit në _____ ka vërtetuar se pjesa e aluajtshmerisë kontestuese bien – gjegjësisht e përbejnë pjesët e parcelave të cekura me lart me masë dhe kufij të shënuara si në ekspertizën e dhënë me shkrime dhe plotsimit të saj dhe skicën e terrenit, e cila është pjesë përberëse e kësaj ekspertize dhe të aprovuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga skica e terrenit të dt. 30.11.2016, shifet shtrirja, vendi, perkufizimi dhe sipërfaqja e paluajtshmerisë tani lëndore dhe atë të pjesëve të ngastrave kadastrale nr. _____ dhe _____

Nga kopia e planit të lëshuar nga Drejtoria Gjeodete Komunale në _____ e dt. 02.12.2016 shifet shtrirja si dhe perkufizimi i paluajtshmerisë tani lëndore.

Dëshmitari _____ deklaroj se ai personalisht e di se babai i tani paditsit – I ndjeri _____ e ka blerë për 50 viteve patundeshmerinë nga shitesi mbieemri I të cilit tani për tani nuk më kujtohet, në sipërfaqe rreth 35 ari, me cmim të shiteblerejes prej 100,000 din të atëherëshëm të cilin cmim shitbleresi Ia ka paguar në teresi shitesit. E di shitblerja është bërë sipas marrëveshjes gojore dhe nuk e di se kanë bërë ndonjë kontrat. E di se kur e kanë blerë aty nuk ka pas ndonjë objekt të ndertuar në patundeshmeri por të njëjten e kanë mbjellur her me misër e her me grun. Ajo paluajtshmeri nuk ka qenë e rrethkuar por vetëm e ndame me gurë të mëgjes. Ndërsa pas një kohe të njëjten e kanë ndare me gardh prej telit ku edhe tani paditesi ka ndertuar shtëpinë e tijë dy katëshe. E di se menjëherë ka hyr në shfrytëzim dhe posedim së bashku me anëtarët e familjes dhe të cilin e kanë shfrytëzuar pa ndërprerë në mënyrë të papërgjegjshme nga askush. Këto rrethana më janë të njohura sepse unë të njëjtin e kam kusheri – bashkëfshatar.

Deshmitari deklaroi se babai i tani paditsit -- I ndjeri ? e ka blere ne vitin 1966 patundeshmerine nganje shites e di qe ka qene serb emir I te cilit tani per tani nuk me kujtohet , ne siperfaqe rreth 70 ari ne pergjithese, ndersa tani paditesit nga ndarja me vellezerit e tij e di qe I kane takuar reth 35 ari, me cmim te shitebleresjes prej 100,000 din te athershem te cilin cmim shitbleresi Ia ka paguar ne teresi shitesit. E di shitblerja eshte bere sipas marreveshjes gojore dhe nuk e di se kane bere ndonje kontrat. E di se kur e kane blere aty nuk ka pas ndonje objekt te ndertuar ne patundeshmeri por te njejten e kan mbjellur her me miser e her me grun. Ajo paluajshteshmeri nuk ka qene e rrethkuar por vetem e ndame me gure te megjes. Ndersa pas nje kohe te njejten e kane ndare me gardh prej telit ku edhe tani paditesit ka ndertuar shtepine e tije dy kateshe. E di se menjehere ka hyr ne shfrytezim dhe posedim se bashku me aneteret e familjes dhe te cilen e kane shfrytezuar pa nderprere ne menyre te papengueshme nga askush. Keto rrethana me jane te njohura sepse une te njejtin e kam kusherri - bashkefshatar.

Nga nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte, gjykata konstatoi se paditesi e ka fituar te drejten e pronesise ne pjeset e parcelave se lartcekura e cila eshte objekt shqyrtimi te cilen e kishte pasur ne posedim dhe shfrytezim shum vite me pare, duke e shfrytezuar kete padundeshmeri me gjate se 20 vite, kohe kjo e parapare per fitimin e te drejtes se pronesise ne baze te parashkrimit fitues - me mbajtje konform dispozites se nenit 28.4 te Ligjit mbi Marredheniet Themelore Juridike - Pronesore, ku eshte percaktuar se mbajttesi me mirebesim i sendit te paluejtshem , mbi te cilin tjetri ka te drejten e pronesise, fiton te drejten e pronesise mbi kete send me parashkrimin fitues me kalimin e kohes prej 20 (njetzet) vjetesh.

Paditsi te drejten e pronesise ne kete patundeshmeri e ka fituar edhe konform nenit 73 te Ligjit per Marredheniet Detyrimore pasi qe kontraten gojore te lidhur ne mes paraardhesit te tij - babait dhe shitsit - tan ketu te paditurit e kishte permbushur ne teresi, pasiqe e kishte paguar cmimin kontraktues dhe poashtu kishte hyr ne posedim dhe shfrytezim te kesaj patundeshmerie menjehere pas blerjes se te njejtës duke mos qene i penguar nga askush e te cilen tani ketu paditsi edhe sot e shfrytezone. Poashtu ne kontekstin e provave te larte cekura, gjykata ne baze te proves se vendshiqimit, konstatoj se paditsi edhe tani e tutje e ka ne posedim dhe shfrytzim kete paluejtshmeri, ne vijimsi te konsiderates se te njejten e ka ne posedim te vetin te fituar me shitblerje dhe me mbajtje me mirebesim.

Kete gjendje te tille faktike gjykata e vertetoi edhe ne baze te deshmitave te dhenea nen betim te deshmitareve nga fsh, Komuna e dhe nga fsh. Komuna e te cileve ua fali besimin e plote, pasiqe te njejtat ishin bindese dhe ne harmoni me kerkespadine.


Gjykata ne kete rast i aplikoi dispozitat e LMTHJP dhe LMD, nga se raporti juridik konkret i qeshtjes kontestimore eshte sajuar ne kohen kur ne aplikim kane qene ligjet e lartecekura.

Vendimin qe secila pale ti barte shpenzimet e tjera te procedures kontestimore, bazohet konform nenit 459.1 te LPK-se.

Nga permbledhja e fakteve dhe arsytet ligjore te cekura me lart, konform nenit 143.1 te LKK -se, u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C.nr.531/2015, dt.19.01.2017.

Gjyqtari,
Skender Shala



KESHILLE JURIDIKE: Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa, ne afat prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimet te te njejtit, Gjykatës se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.